

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEKC 16 164 511**

Sa i përket tenderit për: **Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm**

Nr/Br. 29117  
Date/Datum 27.01.2017  
PRISHTINË - PRIŠTINA

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**FAM** (Förderanlagen Magdeburg) Gjermani & **N.T.SH. EKOINVEST** - Prishtine  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. Agim Ramadani C1/9**  
(Adresa)  
**Prishtine** **10000**  
(Vendi) (Kodi postar)  
**+377 44 30 30 68**  
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

**Lorik Kocani**  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)  
**info@ekoinvest.co**  
(Adresa elektronike)

**27.01.2017**  
(Data e parashtrimit të kërkesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e publikimit të njoftimit: 27.04.2016

Data e skadimit: 07.06.2016

Njoftimi për eliminim: 16.11.2016

Njoftimi për dhënie të kontratës: 16.11.2016

Data e dërgimit të kërkesës për rishqyrtim: 21.11.2016

Data e kthimi të lendes në Rivlerësim: 23.11.2016

Njoftimi për eliminim anulim të tenderit: 05.01.2017

Njoftimi për tenderuesin e eliminuar: 06.01.2017

Data e dërgimit të kërkesës për rishqyrtim: 11.01.2017

Vendimi i AK KEK i kërkesës për rishqyrtim: 18.01.2017

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Gjithsej kane marre pjese 6 kompani,  
Nuk ka vërejtje

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐



## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Ne me date: 16.11.2016 kemi marre njoftimin për tenderuesin e përgjegjshëm por te pasuksesshëm për shkak te çmimit me te larte. Me date 21.11.2016 kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK KEK, te cilët me date 23.11.2016 e aprovojnë kërkesën tone si te bazuar dhe lenden e kthejnë ne rivlerësim.*

*Me date 06.01.2017 na dërgohet letra standarde për tenderuesin e eliminuar pasi qe ne sipas AK KEK kemi dorëzuar oferte te papërgjegjshme. Ky vendim është ne kundërshtim me raportin e komisionit te pare te vlerësimit, pasi qe ne ishim te kualifikuar si OE i përgjegjshëm.*

*Ne me date 11.01.2017 përsëri parashtrojmë kërkesë për Rishqyrtim, te cilën AK e refuzon me date 18.01.2017.*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 59 – i LPP-se**

**Neni 28 – par.6 dhe par 7 i LPP-se**

**Neni 60 - i LPP-se**

**Neni 41 – UOPP-se**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

*Ne me date: 16.11.2017 kemi pranuar njoftimin për tenderuesin e përgjegjshëm por të pasuksesshëm për shkak te çmimit me te larte, sipas raportit te komisionit te vlerësimit te AK KEK te datës 15.11.2016.*

*Me këtë rast ne kemi kërkuar qasje ne dokumentacion tenderik, ku pas analizës se ofertës te OE te rekomanduar për kontrate kemi vërejtur se i njëjti ka përvetësuar, falsifikuar dhe manipuluar me dokumente ne ofertën e tij. Ne më date 21.11.2016 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK duke i njoftuar për falsifikimet e gjetura në ofertën e OE*



te rekomanduar për kontrate, te cilët me date 23.11.2016 si pasoje e këtyre përvetësimeve, falsifikimeve, mashtrimeve dhe manipulimeve me oferte i aprovojnë pikat e kërkesës tone dhe lëndën e kthejnë ne rivlerësim.

**Dëshmia 1: Kërkesa për rishqyrtim i datës 21.11.2016**

Me datë 06.01.2017 për çudi tone edhe pse ne ishim OE i vetëm i përgjegjshëm për këtë aktivitet te prokurimit, ne pranojmë letrën standarde për tenderuesin e eliminuar pasi që sipas AK KEK kemi dorëzuar oferte te papërgjegjshme, që është ne kundërshtim dhe përben shkelje flagrante me raportin e komisionit të parë të vlerësimit.

**Dëshmia 2: Njoftimi për tenderuesin e eliminuar 06.01.2016**

Ne me date 11.01.2017 përsëri parashtrojmë kërkesë për Rishqyrtim, te cilën AK KEK e refuzon si te pa bazuar me datë 18.01.2017.

**Dëshmia 3: Kërkesa për rishqyrtim i datës 11.01.2017**

Si ne letrën për tenderuesin e eliminuar te datës 06.01.2017 edhe ne vendim te gjitha pikat ankimore janë te njëjta, d.m.th. AK KEK fare nuk e ka analizuar dhe kundërshtuar asnjë pike te pretendimeve tona, për te cilat ekzistojnë fakte te mjaftueshme se ne jemi OE i përgjegjshëm.

**Dëshmia 4: Vendimi i AK KEK i datës 18.01.2017**

Arsyetimi i AK KEK se ne jemi diskualifikuar pasi që kemi ofruar stacionin komplet te ri me te gjitha pajisjet e reja, është i pa logjikshëm, tendencioz dhe i qëllimshëm, pasi që u eliminua OE i preferuar dhe i favorizuar i tyre.

Ne kemi ofruar riparim me te gjitha pjesët e reja. Pjese ne fjale jane te gjitha te korroduara dhe jane me shume se 40 vite ne pune.

**Dëshmia 5: foto te stacioni qe duhet te riparohet**

Pra, edhe pse logjikisht është e pakuptimtë mos pranimi i riaprimin me pjesë te reja, edhe ligjërisht është konform dispozitave ligjore sipas nenin 28 par. 6 te LPP-se, Përgjegjshmërinë tone e ka vërtetuar edhe raporti i komisionit te pare te vlerësimit.

**Dëshmia 9: Neni 28 i LPP-se, par. 6**

**Dëshmia 7: Raporti i komisionit te pare te vlerësimit**

Pra, ne kemi garantuar dhe tejkualuar kërkesën e AK KEK se parametrat baze për stacionin ne fjale do te jene, sipas dosjes se tenderit.

Te kërkuara sipas DT	Te ofruara
Shpejtësia e shiritit $v = 4.5 \text{ m/s}$	Shpejtësia e shiritit $v = 4.5 \text{ m/s}$
Gjerësia e shiritit $B = 1800 \text{ mm}$	Gjerësia e shiritit $B = 1800 \text{ mm}$
Kapaciteti $Q_h = 2500 \text{ m}^3/\text{h}$ ,	Kapaciteti $Q_h = 5500 \text{ m}^3/\text{h}$ ,
Gjatësia finale: 1300	Gjatësia finale: 1300



Pra, kërkesat themelore për këtë stacion ngasës janë përmbushur në tërësi ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, duke ofruar një stacion me kapacitet transportues dyfish më të madh.

- Pretendimi i AK KEK se ne nuk kemi ofruar formë të re të stacionit ngasës është i paqëndrueshëm, pasi kjo është zgjidhje bashkëkohore, teknologji e re me të gjitha parametrat e kërkuara në dosje të tenderit, për funksionimin dhe integrimin me të gjitha sistemet tjera ekzistuese në këtë linjë transportuese. Për më tepër Aneksi 2 është **shembull i stacionit ngasës** kjo shihet edhe nga vetë emërtimi "**Aneks 2 Sample of driving station**", Po të mos ishte shembull, do të ishte në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 i LPP-se, ku thuhet:

*"Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "**ose ekuivalent**"*

Dëshmia 9: Neni 28 i LPP-se, par. 7

Pretendimet e komisionit të vlerësimit për pjesën mekanike se nuk përputhen të dhënat me dosje të tenderit përkatësisht me anekset e përmendura, janë të paqëndrueshme tendencioze dhe kontradiktore me kërkesat e dosjes së tenderit, vetëm dhe vetëm me qëllim të anulimit të tenderit.

Ne piken 4.4.1. Kërkesa për reduktor thuhet:

*...Shpjegim: (Ne disponojmë reduktor  $P=800kW$ ,  $i=14,79$ ;  $nd=67^\circ/min$ , shpejtësia e shiritit  $v=4.5m/s$ ) kontraktuesi mund të ofroj zgjidhje tjetër të reduktorit por duhet ta ketë parasysh që mos të ndryshojë shpejtësinë e shiritit të konvejerit), i kompletuar me pajisjet për kontrollimin elektronik të temperaturës së vajit, vibrimeve dhe temperaturës dhe lubrifikimit të kushinetave në reduktor. Te montohen nxemset e vajit. Reduktori të monitorohet nga pajisja programuese PLC. Shënim: Reduktorët lidhen në një tambur ngasës me dy flanaxha...*

Dëshmia 10: Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme 4.4.1

Ashtu siç shkruhet edhe në kërkesë shumë qarte shihet se kontraktuesi mund të ofroj zgjidhje tjetër të reduktorit por duhet ta ketë parasysh që mos të ndryshojë **shpejtësinë e shiritit të konvejerit**. Pra me këtë vërtetohet se edhe në kërkesë që në si OE ofertues mund të ofrojmë zgjidhje me bashkohore, (ashtu siç në keni ofruar) me të cilën nuk ndryshohet shpejtësia e shiritit dhe parametrat tjera baze. Vizatimet e ofruara në **aneksin 8** janë reduktor të cilët janë prodhuar para me shumë se 40 viteve nga kompania SERBE 14 OCTOBAR, e cila nuk ekziston më. Teknologjia bashkëkohore ka avancuar dhe ne të njëjtën kohë edhe gabaritet e reduktorëve kanë ndryshuar, dhe janë bërë më eficiente.

Për më tepër, në **Specifikimet teknike të detyrueshme në fazën e ofertimit pika 4.**



## Thuhet:

*Prej aneksit 5 deri te aneksi 15, janë si shembull informativ duke u bazuar në konvejerin D2.2 ku mund të merren dimensionet si informatë por punët duhet të bëhen sipas specifikimit të detyrueshëm.*

### Dëshmia 11: Specifikimet teknike te detyrueshme pika 4.

Pra, AK KEK thirret ne **aneksin 8** e cila bën pjese ne grupin e anekseve ku janë vetëm informative. Pra, nuk ka te drejte AK KEK të pretendon se nuk plotësohen dimensionet pasi qe janë pjese e anekseve informative te cilët i referohen.

AK KEK thotë se nuk është përmendur materialin për reduktor dhe boshte, kjo shume lehte kishte mundur te vërtetohet ne internet pasi qe jane produkte te SIEMENS & FLENDER, po ashtu ne rast te paqartësive AK KEK ka qene i detyruar te shfrytëzoj te drejtën ligjore për sqarime shtese sipas nenit 72 te LPP-se.

- Sa i përket pretendimit për mungese të flanaxhave gjithashtu është i paqëndrueshëm pasi qe sipas **Specifikimet teknike te detyrueshme ne fazën e ofertimit pika 4**, edhe këto vizatime bëjnë pjese ne grupin e anekseve qe janë informative. Projekti detal i tyre behet pas nënshkrimit te kontratës.

Ashtu sic ka kërkuar AK KEK, ky projekt është me çelësa në dore, dhe nuk ka kurrfarë kuptimi edhe është absurde të thoni se mungon flanaxha, kur dihet se ai duhet të lëshohet në punë. Për më tepër, ne pjesën Technical Descripton Mechanical part te ofertës tone ne shume qarte e kemi konfirmuar se ngasjet do te jete me flanaxha ne te dy anët.

### Dëshmi 12: Technical Descripton Mechanical Part

*Ne vijim po ju paraqesim te gjitha pretendimet e AK KEK ne mënyre te detajuar te cilët i referohen anekseve te cilat shërbejnë vetëm si shembull informativ.*

#### **Pretendimet e AK KEK për mos përmbushje te kritereve teknike për reduktor.**

Pretendimi i pare:

1. *Përmasat gjeometrike te flanaxhes lidhëse – gjegjësisht boshti dalës i reduktorit te përvetësuar nga katalogu i cekur me sipër nuk përputhen me të dhënat e DT (aneksi nr.8).*
- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi qe AK KEK thirret ne aneksin 8, i cili është vetëm për informacion.

### Dëshmia 11: Specifikimet teknike te detyrueshme pika 4.

Pretendimi i dyte:

2. *Karakteristikat kinematike te reduktorit per ngasjen e shiritit nga DT jane: ( $i=14.79$ ;  $n_2= 67 \text{ min}^{-1}$ ;  $P=800 \text{ KW}$ ;) te cilat nuk perputhen me karakteristikat kinematike qe OE i ka përzgjedhur ne oferte: ( $i=14$ ;  $n_2= 71 \text{ min}^{-1}$ ;  $P=798 \text{ KW}$ ;) ,*
- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi qe vete ne oferte shkruan se këto te dhëna janë për informacion, dhe se ne posedojmë me këtë tip te reduktorit, ne



kërkesë shumë qarte shkruan se: ***kontraktuesi mund të ofroj zgjidhje tjetër të reduktorit por duhet ta ketë parasysh që mos të ndryshojë shpejtësinë e shiritit të konvejerit.***

Pretendimi i trete:

3. *Vizatimi i reduktorit ngasës te shiritit B=1800 mm nuk i përgjigjet aneksit 8, (skica për pamjen e mbërthyer te nyjës ngasëse: reduktor, tambur dhe bazament). E ofruar nga OE është në kundërshtim me përzgjedhjen e vetë OE që e ka bërë në katalog.*
- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi përsëri thirren në aneksin 8, i cili bën pjesë në grupin e anekseve që shërbejnë për informacion.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike të detyrueshme pika 4.

Pretendimi i katërt:

4. *Në përshkrimin teknik nuk është shënuar materiali i shtëpizës së reduktorit që duhet të jetë GG20, si dhe materiali për dhëmbëzore dhe boshte të dhëmbëzuara që duhet të jetë: 18CrNiMo7-6 sipas EN10084-1998.*
- Në kemi ofruar reduktor nga prodhuesi SIEMENS që shumë lehtë AK KEK ka mundur ta vërtetojë në internet apo ta shfrytëzojë të drejtën ligjore sipas nenit 72 të LPP-se për të kërkuar sqarime shtese.

Pra, oferta jone nuk është në kundërshtim me të dhënat e dosjes së tenderit – specifikimi teknik i detyrueshëm, pasi këta thirren në anekse të cilat shërbejnë vetëm për informacion.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike të detyrueshme pika 4.

***Pretendimet e AK KEK për mos përmbushje të kritereve teknike për tambur.***

Pretendimi i parë:

1. *Ofertuesi në këtë pozicion nuk ka respektuar të dhënat e kërkuara sipas përshkrimit teknik në specifikim dhe përmasat gjeometrike të cilat duhet të përfillen për shkak të kompatibilitetit (përshtatshmërisë) me pajisjet e tjera të cilat janë në stacionet vepruese të sistemit të II-te të djerrinës.*  
*Për poz. 4.4.2. vizatimi teknik është jo komplet në të cilin mungojnë: mënyra e lidhjes së fllanxhave, dimensionet e boshtit janë jo komplete, materialet e pa definuar (shiko D.T. aneksi 9).*
- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi që përsëri AK KEK thirret në aneksin 9, aneks ky i cili bën pjesë në grupin e atyre që janë si shembull informativ.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike të detyrueshme pika 4.

Pretendimi i dytë:

2. *Aneksi 10. Në skicën e treguar janë dhënë dimensionet dhe është paraqitur forma e mbërthimit për shtrëngimin e tamburit.*  
*Ofertuesi në këtë pozicion nuk ka respektuar formën konstruktive e cila duhet të përfillet për shkak të kompatibilitetit (përshtatshmërisë) me pajisjet e tjera të cilat*



*janë ne stacionet vepruese te sistemit te II-te te djerrinës.*

- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi qe përsëri AK KEK thirret ne aneksin 10, aneks ky i cili bene pjese ne grupin e atyre qe janë si shembull informativ.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike te detyrueshme pika 4.

Pretendimi i trete:

3. *Aneksi 11. Ne skicën e treguar jane dhene dimensionet dhe eshte paraqitur forma e mbërthimit per tamburin devijues – shtypës.*  
*Ofertuesi ne kete pozicion nuk ka respektuar formën konstruktive e cila duhet te perfillet per shkak te kompatibilitetit (përshtatshmërisë) me pajisjet e tjera te cilat janë ne stacionet vepruese te sistemit te II-te te djerrinës.*

- Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi qe përsëri AK KEK thirret ne aneksin 11, aneks ky i cili bene pjese ne grupin e atyre qe janë si shembull informativ.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike te detyrueshme pika 4.

***Pretendimet e AK KEK për mos përmbushje te kriterëve teknike për reduktorin per shtrëngimin e shiritit transportues.***

Pretendimi i pare:

1. *Ne këtë pozicion janë kërkuar (shiko kolonën Aneksi) Aneksi 12 qe duhet te respektohen te dhënat teknike ne vijim.*
- Ofertuesi ne këtë pozicion nuk ka respektuar formën konstruktive e cila duhet te perfillet për shkak te kompatibilitetit (përshtatshmërisë) me pajisjet e tjera te cilat janë ne stacionet vepruese te sistemit te II-te te djerrinës.
  - Ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi qe përsëri AK KEK thirret ne aneksin 12, aneks ky i cili bene pjese ne grupin e atyre qe janë si shembull informativ.

**Dëshmia 11:** Specifikimet teknike te detyrueshme pika 4.

Pra, te gjitha pretendimet e AK KEK për eliminimin tone janë te paqëndrueshme, te dëshmuara me fakte, për arsye se ata thirren ne anekse te cilat shërbejnë vetëm si shembull informativ. Pra, këtu shihet qarte manipulimi dhe tendenca për te na eliminuar neve dhe për ta anuluar projektin ne tërësi pasi qe nuk kane arritur ta shpërblejnë me kontrate OE tyre te preferuar.

Pra, AK KEK nuk ka respektuar:

Nenin 59 te LPP-se, pasi qe AK KEK nuk ka bere ekzaminimin dhe vlerësimin e duhur te dosjes se tenderit.

Neni 28. par. 6 Te Lpp-se, Pasi qe na eliminojnë neve pa baze, edhe pse ne kemi ofruar produkt i cili i ka te gjitha parametrat funksional sipas dosjes se tenderit.

Neni 28 par. 7 i LPP-se, Pasi i referohen një aneksi qe është shembull informativ,

Nenin 41 te UOPP-se – ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, - pasi qe ne jemi OE i vetëm i cili substancialisht i plotëson kërkesat konform këtij neni.



**Kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të vazhdohet me njoftimin për dhënie të kontratës pasi që ne jemi kompania e vetme e përgjegjshme.**

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Tani për tani të papërcaktuara.**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

**\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**